

LIGJI PËR SHËNDETËSI PUBLIKE

Kuvendi i Kosovës,

Në bazë të Kreut 5.1(ë) dhe 9.1.26(a) të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9, datë 15 maj 2001);

Miraton:

LIGJIN PËR SHËNDETËSI PUBLIKE

**Kapitulli I
Përkufizimet**

**Neni 1
Definimi i termave të përdorura në Ligj**

- a) Shëndetësia publike: disiplinë e pavarur që merret me identifikimin dhe zgjidhjen e të gjitha problemeve të bashkësisë nga të gjitha pikëpamjet shëndetësore, parandalimin e sëmundjeve, hulumtimin e etiologjisë së sëmundjeve, promovimin e shëndetit, rehabilitimin dhe riadaptimin e të hendikepuarve, edukimin shëndetësor dhe çështjet sociale.
- b) Dezinfektimi: shkatërrimi i agjensëve infektiv jashtë organizmit që bëhet me ndihmën e mjeteve fizike, kimike dhe veprimeve të ndryshme.
- c) Dezinfektimi: është shkatërrim i vektoreve-artropodeve me metodat fizike, kimike dhe biologjike.
- d) Deratizimi: asgjësimi i brejtësve me metoda të caktuara mekanike, biologjike dhe kimike.
- e) Epidemia: paraqitja e dy apo më shumë rasteve të një sëmundjeje ngjitëse, të lidhura ngushtë mes veti në kohë dhe territor të caktuar apo rritjen enorme të numrit të rasteve të një sëmundjeje ngjitëse.
- f) Vaksinoprofilaksa: bartja e shkaktarëve të sëmundjeve ngjitëse apo të produkteve të tyre të mbytur ose të dobësuar në organizmin e njeriut apo të kafshës me qëllim të formimit të imunitetit aktiv specifik.
- g) Zona endemike: territori ku është e pranishme sëmundja ngjitëse për një kohë të gjatë në rrethana të caktuara e cila në kushte të favorshme mund të përhapet në masë në formë epidemie.
- h) Preventiva shëndetësore: intervenimi strategjik i bazuar në shkencë në rrjedhën natyrore të shkaqeve që shpijnë drejtë dëmtimit të shëndetit e me qëllim të reduktimit efektiv të shkaktarëve të mundshëm si dhe pasojave eventuale nëse vjen deri tek dëmtimi i shëndetit.
- i) Edukimi shëndetësor: kompleks i masave për të mësuar, për te ngritur mundësitë e njohurive shëndetësore si dhe shkathtësive jetësore të individëve dhe bashkësisë që kanë për qëllim ndërrimin e sjelljeve për të ruajtur shëndetin.
- j) Parandalimi i sëmundjes: kompleks i masave me qëllim të parandalimit të zhvillimit, përhapjes së sëmundjes, parandalimit të përparimit të sëmundjes dhe pasojave të saja.
- k) Imunizimi: parandalimi i sëmundjeve ngjitëse me preparate imunologjike - vaksina dhe serume: mase efikase profilaktike dhe kundër epidemike, qëllimi i të cilës është që të zhvilloj mbrojtjen aktive dhe pasive kundër sëmundjeve.
- l) Komunikimi shëndetësor: aktivitet për të realizuar informimin e popullatës lidhur me brengat shëndetësore si dhe mbajtjen e qëndrueshme të çështjeve shëndetësore në agjendat e vendimmarrësve dhe publikut.

- m) Avokimi për shëndet: çdo aktivitet i ndërmarrë nga individ i apo përfaqësuesit e grupeve të interesit me qëllim të ngritjes së çështjes shëndetësore me interes të bashkësisë para vendimmarrësve e për të realizuar përparimin, parandalimin dhe trajtimin adekuat shëndetësor.
- n) Sjelljet shëndetësore: aktivitet me qëllim të përparimit, parandalimit dhe mbrojtjes shëndetësore pa dallim se a është fjala për gjendjen shëndetësore të vlerësuar apo ekzistuese.
- o) Shëndeti mjedisor: kontrolli i të gjithë faktorëve në mjedisin fizik të njeriut të cilët ushtrojnë ose mund të ushtrojnë një efekt negativ në zhvillimin e tij fizik dhe psikik, shëndetin apo kushtet jetësore.
- p) Ndotja: ndryshimet jonormale të padëshirueshme në karakteristikat fizike, kimike, biologjike të ujit, ajrit, tokës dhe ushqimit që ndikojnë apo mund të ndikojnë negativisht në shëndetin e njeriut dhe organizmave tjerë të gjallë.
- q) Ndotësi: elementi, material, substanca (fizike, kimike, biologjike me origjinë natyrale ose sintetike) që nuk është përbërës i strukturës normale (huaj) ose "mbi vlerat maksimale të lejuara"(VML).
- r) Sanitacioni: tërësia e masave higjienike sanitare që ka të bëjë me ruajtjen dhe përparimin e shëndetit mjedisor.
- s) Edukimi sanitar: proces nëpërmjet të cilit individ dhe bashkësia mësohen të mbrojnë, ruajnë, përmirësojnë dhe rifitojnë shëndetin e tyre.
- t) Banka e mostrave mikrobiologjike: mbledhja, ruajtja dhe konservimi i mostrave me rëndësi të veçantë në kushte të parapara.
- u) Programi i zgjeruar i imunizimit: përmban mbikëqyrjen e sëmundjeve vaksinë preventabile, vaksinimin, prokurimin e vaksinave dhe materialit tjetër, zinxhirin e ftohtë dhe menaxhimin e stoqeve, imunizimin e sigurt, injektimin e sigurt, mbikëqyrjen e efekteve të padëshiruara pasvaksinale, eliminimin e indikacioneve epidemiologjike dhe trafikut ndërkombëtar.
- v) Grupet senzitive: familjet një prindërore, fëmijët jetim, të varfrit ekstrem, viktimat e trafikimit, të sëmurët kronik, të moshuar, të burgosurit, të pa strehët, përdoruesit e drogës me injektim, të sëmurët mental e veçmas PTSD (post-traumatic stress disorders - personat me çrregullime post-traumatike).
- w) Gjendja e jashtëzakonshme: janë situata të rrezikimit të shëndetësisë publike pas shpërthimit të epidemive masive, tërmeteve, zjarreve, thatësirave, vërshimeve, erërave të forta, migrimeve masive të popullsisë, luftërave e situata tjera të ngjashme.

Kapitulli II

Dispozitat e Përgjithshme

Neni 2

Veprimtaria e shëndetësisë publike është veprimtari me interes të veçantë për shoqërinë si në nivelin kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar.

Neni 3

3.1 Institucionet që ushtrojnë veprimtari të shëndetësisë publike, në aspektin ligjor, i nënshtrohen mbikëqyrjes të siguar nga themeluesi.

3.2 Në aspektin profesional veprimtaria e shëndetësisë publike i nënshtrohet mbikëqyrjes profesionale të brendshme dhe të jashtme.

Neni 4

4.1. Ministria e Shëndetësisë përpilon dhe monitoron zbatimin e politikave të shëndetësisë publike përmes Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës.

4.2. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHP) është institucion publik i cili ushtron veprimtari referente në lëmin e shëndetësisë publike si në vijim:

- a) Planifikimit dhe programimit shëndetësor;
- b) Përpunimit, analizës dhe publikimit të të dhënave në lëmin e ekonomikes shëndetësore;
- c) Kontrollit të kualitetit të punës;
- d) Kontrollit të gatishmërisë dhe të përgjegjësisë epidemiologjike;
- e) Menaxhimit dhe vlerësimit të situatës epidemiologjike të sëmundjeve ngjitëse;
- f) Menaxhimit të Programit të zgjeruar të imunizimit;
- g) Menaxhimit të infeksioneve intra hospitalore;
- h) Analizimit dhe vlerësimit të gjendjes higjienike sanitare në objektet publike dhe private;
- i) Analizimit dhe vlerësimit të kualitetit të ujit për pije;
- j) Analizimit dhe vlerësimit të sanitacionit;
- k) Analizimit dhe vlerësimit të kualitetit të ushqimit dhe ushqyeshmërisë;
- l) Analizimit dhe vlerësimit të aerondotjes;
- m) Analizimit dhe vlerësimit të higjienës në objektet parashkollore dhe shkollore;
- n) Analizimit dhe menaxhimit të veprimtarive lidhur me mikrobiologjinë e mjedisit;
- o) Vlerësimit dhe kontrollit të laboratorëve që ushtrojnë veprimtari në lëmin e shëndetit publik;
- p) Qendër referente në lëmin e shëndetit publik për TBC, HIV/AIDS dhe IST;
- q) Qendër referente në lëmin e shëndetit publik për zoonozë;
- r) Qendër referente në lëmin e shëndetit publik për promovimin dhe edukimin shëndetësorë;
- s) Analizimit, vlerësimit dhe menaxhimit të mbrojtjes shëndetësore të kategorive të veçanta të popullatës me rëndësi sociale mjekësore si dhe sëmundjet malinje, kardiovaskulare, diabeti e të ngjashme;
- t) Grumbullimit, përpunimit dhe analizimit të të dhënave nga Sistemi i Informimit shëndetësor (SISH) dhe propozimit të masave për avancimin dhe menaxhimin e SISH-it;
- u) Grumbullimit, përpunimit dhe analizimit të të dhënave nga Sistemi i Informimit gjeografik (SIGJ) dhe propozimit të masave për avancimin dhe menaxhimin e SIGJ-it;

4.3. IKSHPK për realizimin e suksesshëm të veprimtarisë së vet bashkëpunon ngushtë me institucionet qeveritare dhe joqeveritare.

4.4. IKSHPK koordinon dhe mbikëqyrë veprimtaritë dhe aktivitetet e shëndetit publik në njësitë organizative të saja.

Neni 5

5.1. IKSHPK si Institucion më i lartë shëndetësor, profesional dhe shkencor i

5.2. Kosovës organizon, zhvillon, mbikëqyrë dhe zbaton politikat e shëndetësisë publike në Kosovë.

5.3. Veprimtaria, organizimi dhe menaxhimi i IKSHPK-së rregullohet me statut.

Kapitulli III Shëndeti Mjedisor dhe Banimi

Neni 6

6.1. IKSHPK hulumton ndikimin e faktorëve mjedisor në shëndetin e popullsisë dhe i propozon masat mbrojtëse për parandalimin e efekteve të dëmshme për shëndet.

6.2 IKSHPK propozon dhe ndërmerr veprime profesionale dhe u rekomandon institucioneve kompetente eliminimin e mangësive të zbuluara dhe çfarëdo efekti të dëmshëm për shëndetin.

6.3 Brenda sferës së aktiviteteve të lidhura me shëndetin e mjedisit dhe atij të banimit, IKSHPK do të:

- a) njoftoj popullatën lidhur me shkaqet e ndotjes së mjedisit i cili mund të kërcënon shëndetin.
- b) elaboron sistemin e raportimit të dëmtimit të shëndetit dhe sëmundjeve përkitazi me efektet e mjedisit.

Neni 7

7.1 IKSHPK rekomandon dhe zbaton masat mbrojtëse nga fusha e veprimtarisë së ekologjisë humane:

- a) mbikëqyrja dhe kontrolli i ujit të pijshëm,
- b) mbikëqyrja dhe kontrolli i ujit të ambalazhuar,
- c) mbikëqyrja dhe kontrolli i ujërave rekreative, burimet natyrale–minerale (banjat) dhe pishinat.

7.2 Kjo çështje rregullohet me akt nënligjor.

Neni 8

IKSHPK hulumton shkaqet dhe pasojat e aerondotjes që dëmtojnë shëndetin publik si dhe i propozon masat mbrojtëse.

Neni 9

IKSHPK hulumton shkallën e kontaminimit të tokës, nga aspekti i kërcënimit të shëndetit publik në mënyre direkte apo të tërthortë.

Kapitulli IV Ushqimi dhe Shëndeti

Neni 10

Është detyrë e IKSHPK që lidhur me artikujt ushqimor që shërbejnë për qëllime të konsumit publik, të hulumtoi helmimet dhe infeksionet e shkaktuara nga artikujt e kontaminuar ushqimor.

Neni 11

IKSHPK hulumton, kontrollon dhe jep rekomandime profesionale lidhur me higjienën sanitare.

Kapitulli V Gjendja shëndetësore dhe ushqyeshmëria

Neni 12

12.1 IKSHPK mbikëqyrë, analizon dhe bënë vlerësimin e gjendjes shëndetësore dhe shkallës së ushqyeshmërisë së popullatës dhe njëkohësisht propozon masat adekuate për përparimin e ushqyeshmërisë.

12.2 Procesi dhe periudha e raportimit të gjendjes shëndetësore të popullatës dhe shkalla e ushqyeshmërisë rregullohet me akt nënligjor.

Neni 13

IKSHPK propozon planin e përgjithshëm në mënyrën e organizimit të vizitave sistematike për fëmijët në entet parashkollore, shkollore dhe grupet me rëndësi të veçantë që duhet t'i nënshtrohen vizitave sistematike nga institucionet kompetente.

Neni 14

IKSHPK përpilon standardet e rritjes, zhvillimit dhe ushqyeshmërisë së popullatës.

Kapitulli VI Shëndeti dhe Rrezatimi

Neni 15

15.1 Efektet e dëmshme të rrezatimit jonizues dhe jo-jonizues janë objekt i mbikëqyrjes, hulumtimit dhe vlerësimit të ndikimit në shëndetin publik.

15.2 Rregullat dhe masat e kujdesit kundër efektit të dëmshëm të rrezatimit, përcaktimi i kushteve të përdorimit, menaxhimit, ruajtjes së substancave radioaktive që përdoren për diagnostifikim dhe terapi rregullohen me akt nënligjor.

15.3 Ekspozimi ndaj rrezatimit jonizues për qëllime diagnostike dhe terapeutike bëhet sipas indikacioneve shëndetësore dhe në pajtim me pacientin.

Kapitulli VII Kujdesi shëndetësor i të punësuarve

Neni 16

16.1 Standardizimi, hulumtimi dhe përcjellja e ndikimit të kushteve dhe kujdesit shëndetësor të punëtorëve rregullohet me akt nënligjor.

16.2 Zbatimi i aktiviteteve nga paragrafi 1 i këtij neni është nën kompetenca të institucionit shëndetësor të autorizuar nga Ministria e Shëndetësisë.

16.3 Punëtorët të cilëve mund t'u rrezikohet shëndeti u nënshtrohen kontrollimeve sistematike mjekësore (makro dhe mikroklima) nga IKSHPK.

Kapitulli VIII Mbrotja shëndetësore në kushte të jashtëzakonshme

Neni 17

Shpallja e gjendjes së jashtëzakonshme në rastet kur konstatohet rrezikshmëria e shëndetit publik rregullohet me akt nënligjor.

Kapitulli IX Veprimtaria diagnostike mikrobiologjike

Neni 18

18.1 Veprimtaria e mikrobiologjisë së Mjedisit kryhet vetëm në laboratorët e institucioneve publike.

18.2 Mikrobiologjia klinike kryhet në institucionet publike, mikse dhe private.

18.3 Në institucionet private dhe mikse nuk lejohet të kryhen shërbimet mikrobiologjike referente si zoonozat, TBC, shkaktarët e sëmundjeve bioterroriste, kontrolli i cilësisë së ujit dhe ushqimit.

Neni 19

19.1 Laboratorët referente të IKSHPK koordinojnë dhe mbikëqyrin laboratorët mikrobiologjike publike dhe private.

19.2 Veprimtaria diagnostike mikrobiologjike në IKSHPK përfshinë organizimin dhe bashkëpunimin me laboratorët në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar për kontrollimin e kualitetit të testeve konfirmuese.

19.3 Kjo çështje rregullohet me akt nënligjor.

Neni 20

20.1 Laboratorët referente në IKSHPK analizojnë dhe vlerësojnë përshtatshmërinë mikrobiologjike të mostrave.

20.2 Laboratorët referente analizojnë dhe vlerësojnë përshtatshmërinë e mostrave për kontrollin e sterilizimit.

20.3 IKSHPK organizon laboratorët referente për:

- a) infeksione enterike,
- b) tuberkuloz,
- c) serologji bakteriale,
- d) mikologji,
- e) parazitologji,
- f) infeksione nozokomiale,
- g) sëmundje seksualisht transmise – STI dhe HIV/ AIDS,
- h) zoonoza dhe sëmundje bioterroriste,
- i) diagnostike molekulare.

20.4 Në IKSHPK gjendet banka e mostrave mikrobiologjike veprimtaria e të cilës rregullohet me akt nënligjor.

Kapitulli X Imunizimi

Neni 21

21.1 Imunizimi me preparate imunologjike është i obligueshëm bazuar në vaksinoprofilaksën dhe imunoprofilaksën sipas programit të zgjeruar të imunizimit për tërë territorin e Kosovës.

21.2 IKSHPK përgatitë programin e zgjeruar të imunizimit dhe në bazë të indikacioneve epidemiologjike dhe Standardeve Ndërkombëtare.

21.3 IKSHPK bënë hulumtimin e kualitetit dhe imunitetit kolektiv të popullatës.

21.4 Ministria e Shëndetësisë, me propozimin e IKSHPK, përcakton listën e sëmundjeve ngjitëse të cilat i nënshtrohen imunizimit të obligueshëm, sipas indikacioneve epidemiologjike dhe rregullores së trafikut ndërkombëtar.

21.5 Imunizimi i obligueshëm mbi vaksinoprofilaksën seroprofilaksën dhe kimioprofilaksën rregullohet me akt nënligjor.

21.6 IKSHPK harton dhe propozon programin e imunizimit të obliguar për vitin kalendarik dhe programin për imunizim të jashtëzakonshëm të cilat i miraton Ministria e Shëndetësisë.

21.7 Qendrat e Mjekësisë Familjare bëjnë zbatimin e programit të imunizimit nën mbikëqyrjen dhe vlerësimin e IKSHPK.

21.8 Komuna harton planin e imunizimit duke u bazuar në Planin e Zgjeruar të Imunizimit.

Neni 22

22.1 Ministria e Shëndetësisë është e obliguar që të bëjë sigurimin dhe furnizimin me preparate imunologjike në bazë të programit nga neni 21.2, të këtij ligji.

22.2 Kompetent për ruajtjen e preparateve imunologjike dhe shpërndarjen e tyre në tërë territorin e Kosovës është IKSHPK.

Neni 23

23.1 Mënyra e udhëtimit individual apo në grupe në vendet endemo epidemike jashtë vendit bëhet nën mbikëqyrjen e IKSHPK-së.

23.2 Personat që kthehen nga vendet endemo epidemike i nënshtrohen kontrollit dhe mbikëqyrjes së obliguar sanitare që nga dita e kthimit për pesë ditë me radhë në IKSHPK.

23.3 Imunizimin, përgatitjen dhe lëshimi i certifikatave ndërkombëtare për persona që udhëtojnë në vendet endemo epidemike jashtë vendit është kompetent ekskluzive e IKSHPK-së.

Kapitulli XI

Masat parandaluese dhe kundër epidemike

Neni 24

Masat parandaluese për sëmundjet kronike jo ngjitëse dhe programi për implementimin e tyre përcaktohet me akt nënligjor.

Neni 25

Dezinfektimi, dezinfektimi dhe deratizimi (DDD) paraqesin masa parandaluese dhe kundër epidemike që rregullohen me akt nënligjor.

Kapitulli XII

Parandalimi i përhapjes së HIV/AIDS

Neni 26

26.1 Institucion referent për diagnostikimin laboratorik dhe parandalimin e HIV/AIDS është IKSHPK.

26.2 Veprimtaria, struktura dhe funksionet e shërbimeve shëndetësore që kanë të bëjnë me HIV/AIDS rregullohen me akt nënligjor.

Kapitulli XIII Promovimi i Shëndetit

Neni 27

27.1 Institucionet shëndetësore, profesionistët shëndetësor si dhe personeli i trajnuar kanë obligim që të bëjnë:

- a) Identifikimin dhe vlerësimin e hershëm të nevojave të bashkësisë dhe individëve lidhur me shëndetin, gjendjeve para sëmundjeve, sëmundjeve dhe ndërlikimeve shëndetësore;
- b) Identifikimin e hershëm të faktorëve që çojnë kah zhvillimi i proceseve jonormale shëndetësore, gjegjësisht ato të cilat çrregullojnë mirëqenien e plotë fizike, mentale dhe sociale.

27.2 Profesionistët shëndetësor, personeli i trajnuar për edukim shëndetësor, institucionet shëndetësore, jo shëndetësore, arsimore dhe shkollat promovuese të shëndetit kanë obligim të organizojnë dhe zbatojnë aktivitetet e promovimit dhe edukimit shëndetësor me qëllim të përparimit të shëndetit, përmirësimit të kualitetit të jetës dhe zvogëlimit apo eliminimit të faktorëve që ndikojnë negativisht në shëndetin.

27.3 Me qëllim të zbatimit të masave të përparimit dhe të parandalimit individët dhe institucionet janë të obliguara të:

- a. Njoftojnë popullatën lidhur me mundësitë për t'iu shmangur faktorëve të rrezikut dhe eliminimit të tyre duke përdorur mjetet dhe metodat që mbrojnë shëndetin;
- b. Njoftojnë për mundësitë dhe përparësitë e ngritjes së rezistencës së organizmit ndaj faktorëve patogjen dhe faktorëve të tjerë të dëmshëm për shëndet;
- c. Njoftojnë në mënyrë të veçantë grupet me sensitive për rolin e zhvillimit të aktiviteteve të promovimit dhe edukimit shëndetësor, me qëllim të zvogëlimit të faktorëve të rrezikut.

Neni 28

28.1 Me qëllim të zbatimit të promovimit dhe edukimit shëndetësor individët dhe popullata do të informohet së paku për:

- a) Ligjet e veprimit në trupin e njeriut dhe ndërveprimet e ambientit natyror, social dhe psikologjik;
- b) Ushqimin, ajrin, ujin dhe tokën e shëndoshë, mënyrën e jetës dhe krijimin e ambientit të shëndoshë;
- c) Higjienën personale trupore, mendore si dhe higjienën kolektive;
- d) Rolin e ushtrimeve fizike, të sportit dhe muzikës në promovimin e shëndetit;
- e) Metodatat për parandalimin dhe zgjidhjen e situatave të stresit dhe për mbizotërimin e konfliktit;
- f) Informatat për parandalimin e infeksioneve seksualisht transmise;
- g) Vartësitë nga substancat psikoaktive, efektet e tyre të dëmshme dhe për mënyrat e shmangies nga to;
- h) Teoria dhe praktika e ndihmës së parë;
- i) Kushtet dhe mundësitë e shfrytëzimit të shërbimeve shëndetësore dhe avokimit për shëndet;
- j) Etika themelore përkitazi me shëndetin.
- k) Mundësinë dhe përgjegjësinë e qytetarit në lidhje me promovimin e shëndetit të tij/saj.

28.2 Edukimi shëndetësor do të zgjerohet gjithashtu në njoftimin me informatat dhe metodat për parandalimin e sëmundjes dhe gjendjes para sëmundjes dhe njohjen e hershme të saj, duke përparuar mundësinë dhe përgjegjësinë e qytetarit në lidhje me promovimin e shëndetit të tij/saj.

28.3 Është detyrë e çdo punëtori të kujdesit shëndetësor që të marrë pjesë në mënyrë aktive në edukimin shëndetësor, në trajnimin e punëtorëve shëndetësor, me theks të veçantë në përgatitjen e tyre për dhënien e këshillave lidhur me mënyrën e jetës;

28.4 Pikëpamjet për edukimin shëndetësor duhet të merren parasysh nga masmediat në elaborimin e politikave të tyre programore.

Neni 29

29.1 IKSHPK është qendër referente e politikës programore edukative shëndetësore, përpilimit, mbikëqyrjes dhe vlerësimit të programeve dhe materialeve të informimit, edukimit dhe komunikimit shëndetësor.

29.2 IKSHPK është qendër referente e zbatimit të edukimit të vazhdueshëm në lëmin e promovimit dhe edukimit shëndetësor.

29.3 Aktivitetet profesionale promovuese edukativo shëndetësore zhvillohen nga IKSHPK-së përmes degëve të saj, përkatësisht sektorit të promovimit dhe edukimit shëndetësorë duke inkorporuar komisionet e promovimit dhe edukimit shëndetësorë.

Neni 30

30.1 Personat, organizatat që hulumtojnë faktorët dhe aktivitetet që rrezikojnë shëndetin e popullatës, dhe personat ose organizatat që kryejnë këto aktivitete kanë obligim të raportojnë. Mënyra e raportimit rregullohet me akt nën ligjor.

30.2 Informata e definuar në nenin 28.1. të këtij ligji bëhet publike për opinionin e plotësuar me informata të domosdoshme për parandalimin e dëmtimit të shëndetit.

Neni 31

31.1 Me qëllim të përcjelljes të zbatimit të aktiviteteve dhe obligimeve të dala nga neni 27.2 IKSHPK organizon Komisionin e promovimit dhe edukimit shëndetësor.

31.2 Mënyra e organizimit dhe funksionimit të Komisionit do të rregullohet me akt nën ligjor.

Neni 32

Çështjet tjera lidhur me promovimin dhe edukimin shëndetësor do të rregullohen me akt nënligjor.

Kapitulli XIV Kujdesi shëndetësor për nënën dhe fëmijën

Neni 33

Promovimi i kujdesit shëndetësor për nënën dhe fëmijën rregullohet me akt të veçantë nënligjor.

Kapitulli XV Kujdesi Shëndetësor për të Rinjtë

Neni 34

34.1 Qëllimi i kujdesit shëndetësor i ofruar për të rinjtë është të promovojë zhvillimin harmonik trupor dhe mendor të tyre përmes:

- a) Edukatës shëndetësore;
- b) Kontrollimit sistematik që i përgjigjet moshës së tyre;
- c) Vaksinimit të obligueshëm që i përgjigjen moshës, analiza e rezultateve dhe efektivitetit të vaksinimeve, si dhe fushatat e vaksinimeve;
- d) Dhënia e udhëzimeve për përcaktimin profesional;

34.2 Në sferën e detyrave të veçanta të kujdesit shëndetësor të ofruar për të rinjtë hyjnë si vijon:

- a) Kontrolli i shtuar dhe kujdesi psikologjik i personave që jetojnë me çrregullime të lindura, i atyre që vuajnë nga sëmundjet kronike me paaftësi trupore, shqisore apo mendore, bazuar në bashkëpunimin me mjekun e tyre familjar, në kujdesin psikologjik, dhe duke promovuar integrimin e tyre në komunitetin e shëndoshë;
- b) Këshillon lidhur me edukatën fizike (trupore) në shkolla, edukatën ndihmëse fizike, dhe sportet studentore;
- c) Konsultimi me prindër dhe mësimdhënës në rast të zbulimit të rrethanave kërcënuese për zhvillimin harmonik trupor dhe mendor, të përdorimit të substancave psikoaktive (droga, alkooli, duhani), dhe nëse është e domosdoshme, iniciimi i masave për tejkalimin e kësaj gjendje dhe infeksionet seksualisht transmise.

34.3 Brenda kornizave të kujdesit shëndetësor për të rinjtë do të përcillen si në vijim:

- a) zbatimi i standardeve të shëndetit publik në ndërtesa që shërbejnë për të ofruar trajnim teorik dhe praktik, si dhe në lëmit e edukimit dhe të rekreacionit në natyrë,
- b) aplikimi i ushqimi i ofruar në infirmieri dhe në institucionet e edukimit dhe të mësimin,
- c) aplikimi i rregullave epidemiologjike,
- d) dhënia e ndihmës së parë,
- e) zbatimi i informimit të rregullt dhe të duhur për dëmet në lidhje me konsumimin e alkoolit, duhanit, substancave narkotike dhe substancave të tjera psikoaktive.
- f) përcjellja e statusit dhe stabiliteti i studentëve dhe i nxënësve,
- g) në rast të sëmundjeve ngjitëse, do të ndërmerren masat e caktuara kundër epidemike;

34.4 Ofrimi i kujdesit shëndetësor në shkolla definohet me akt nënligjor.

34.5 Me qëllim të realizimit të detyrave të tyre, ofruesit e shërbimeve shëndetësore do të bashkëpunojnë me institucionet e edukimit publik, me institucionet dhe personat që ofrojnë asistencë sociale dhe familjare si dhe mbrojtje të fëmijëve.

Kapitulli XVI

Kujdesi Shëndetësor në Lidhje me Sportin

Neni 35

Veprimtaria, struktura dhe mënyra e funksionimit të kujdesit shëndetësor në lidhje me sportin për shkak të specifikave rregullohet me akt nënligjor.

Kapitulli XVII

Pjesa financiare

Neni 36

36.1 Shëndetësia Publike dhe Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike si institucion kryesor i implementimit të Shëndetësisë Publike financohet nga:

- a) Buxheti i Konsoliduar i Kosovës,
- b) Buxheti i Komunave,
- c) Të hyrat vetanake të krijuara përmes shërbimeve të kryera dhe
- d) Donacionet.

36.2 Qeveria e Kosovës përcakton Kodin e veçantë buxhetor për IKSHPK.

36.3 Mënyra e krijimit të të hyrave vetanake dhe mënyra e shpenzimit të tyre përcaktohet me akt nënligjor.

Kapitulli i XVIII Dispozitat disiplinore dhe ndëshkimore

Neni 37

Në rastet e mos zbatimit dhe shkeljeve të dispozitave të Ligjit të Shëndetësisë Publike do të merren masa në pajtim me nenin 118 dhe 119 të Ligjit për Shëndetësi.

Kapitulli XIX Dispozitat kalimtare

Neni 38

Më qëllim të zbatimit të këtij ligji Ministria e Shëndetësisë nxjerr akte nënligjore brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 39

Ky ligj hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Kosovës dhe shpalljes nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

**UNMIK/REG/2008/6
08.02.2008.**